



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



Në bazë të autorizimeve të dhëna me neni 10 të Ligjit nr. 03/L-072 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, nenin 37.2 pika (c), nenin 65.2 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr.03L-040, nenin 5, 6 dhe 7 të Udhëzimit Administrativ për Zëvendësimin e Anëtarit të Kuvendit Komunal, Nr.01/2017, si dhe Aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese, KI45/2020 dhe KI46/20, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, më 11.08.2021, nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **ZNJ.Adelina Rexhepi**, emërohet anëtare e Kuvendit Komunal në Gjakovë, nga subjekti politik "Aleanca për Ardhmërinë Kosovës -AAK" duke e zëvendësuar anëtarin e Kuvendit Komunal znj.Florentina Gjergjaj.
- II. Obligohet Sekretariati i KQZ-së, që ky vendim t'i komunikohet znj.Adelina Rexhepi dhe të ndërmerren veprimet procedurale për zbatim.

Arsyetim

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, ka shqyrtuar shkresat e lëndës të dorëzuara në KQZ më datën 05.08.2021, Nr.1905/2021, për zëvendësimin e anëtares të Kuvendit Komunal znj.Florentina Gjergjaj, me rastin e dorëheqjes së saj, për arsye të zgjedhjes në pozitë e drejtoreshës së shkollës së mesme teknike në Gjakovë.

Pas shqyrtimit të kërkesës dhe shkresave të bashkangjitura, është verifikuar dhe konstatuar, se kandidate e radhës në listën e rirenditur është, znj.Adelina Rexhepi.

Kandidatja ka dhënë deklaratën e pranimit të mandatit si kandidate e radhës, nga i njëjti subjekt politik, e gjinisë së njëjtë dhe me numër më të madh të votave, duke mos tejkalluar kuotën prej 30 %, të kufirit minimal të përfaqësimit gjinor të gjinisë pakicë, sipas rezultateve të certifikuar të zgjedhjeve lokale të vitit 2017. Pas plotësimit të të gjitha kushteve ligjore, KQZ-ja vendosi si në pikën I të këtij vendimi.

- III. Ky vendim, hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Prishtinë, 11.08.2021

Kryesues i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Kreshnik Radoniqi